



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

|  |                               |                              |                               |
|--|-------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar<br>Punje/Prodato<br>Received/Delivery | 09-06                         | 3                            | viti<br>god<br>year           |
| Organ /Njesia<br>Organ /Jednica<br>Org./Unit             | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtet:<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| KPM SHCK   | 4645/2023                     |                              | 115                           |



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova  
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.642/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi- anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.642/2023 të datës 18.04.2023 të parashtruar nga ankuesja nga fshati kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike “Vlerësim në punë”, dhe duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 08.06.2023 mori këtë:

### V E N D I M

- I. **ANULOHE**T vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022 i datës 03.03.2023 për ankuesen
- II. **OBLIGOHE**T Kryetari i Komunës së Obiliqit dhe Udhëheqësi i Prokurimit në cilësinë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet me qëllim që ankueses t’i bëhet rivlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022 për periudhën sa ankuesja ka qenë në varësi të tyre.
- III. **OBLIGOHE**T Kryetari i Komunës së Obiliqit, që ti ndërmarrë të gjitha veprimet që zbatimi i këtij Vendimi të bëhet në sipikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë Vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar sipas Akt Emërimit me numër të protokollit Nr.II/113 të datës 01.06.2023 në pozitën “Zyrtare e Lartë e Prokurimit” në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme në Komunën e Obiliqit, më datë 14.04.2023 përmes e-mailit zyrtar [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 3615/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil të Kosovës e cila është protokolluar me datë 18.04.2023, me pretendimet ankimore se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022, nga



Kryetari i Komunës së Obiliqit në cilësinë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë i është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik që rregullojnë vlerësimin e rezultateve të punës dhe dispozitave të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 24.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 3751/2023 në Komunën e Obiliqit, ndërsa Këshilli më datë 08.05.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë me numër të protokollit Nr.XII-69 së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 30.05.2023 ka nxjerr Vendim VK/2023 me numër të protokollit 4526/2023 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës me numër A.nr.642/2023 të datës 14.04.2023, për dhjetë (10) ditë pune, për shkak të mungesës së provave nga ana e organit të punësimit si dhe nevojës për shqyrtim të mëtejme të çështjes

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesë drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes e-mailit zyrtar më datë 14.04.2023 i protokolluar më numër të protokollit 3615/2023 më datë 18.04.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 03.03.2023; E-mail i datës 17.03.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 03.03.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 28.12.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 24.12.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 18.12.2017; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 04.01.2017; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 13.01.2016; E-mail 18.10.2022; E-maili 14.10.2022; E-maili 20.10.2022; 18.10.2022; Dorëheqje "Kërkesë për heqje të autorizimit" me numër XIII/362 më datë 16.10.2022; Njoftim i datës 02.10.2022; E-mail i datës 21.09.2022; E-mail i datës 20.09.2022; E-mail i datës 03.10.2022; E-mail i datës 05.10.2022; Kërkesë për interpretim me numër XIII-343 e datës 05.10.2022; Përgjigje në kërkesën për interpretim me numër të referencës KRPP-DRR-11-10-269/2022 e datës 11.10.2022; E-mail i datës 06.02.2023; E-mail i datës 19.10.2022; E-mail i datës 17.10.2022; Kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore me numër të referencës AKK-02-28-2849/22 e datës 25.10.2022; Vendim me numër A.nr.633/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i datës 22.09.2022; Vendim me numër A.nr.331/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i datës 31.03.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 3751/2023 e datës 24.04.2023; Përgjigje në ankesë me numër Nr.XII-69 e datës 08.05.2023; Akt Emërim me numër II-113 i datës 01.06.2025; Përshkrim i detyrave të punës më datë 01.06.2015; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 31.01.2023; Autorizim me numër të protokollit Nr.II-85 i datës 09.02.2022; Autorizim me numër të protokollit Nr.II-381 i datës 21.04.2022; Përshkrim i detyrave të punës më datë 18.07.2014; Vendim me numër të protokollit Nr.II-1464 i datës 21.10.2022; Marrëveshje për kryerjen e punëve të përkohshme shtesë në Komunën e Obiliqit në Shërbimin Civil me numër të protokollit Nr.II-1463 i datës 21.10.2022; Kopje e letërnjoftimit për B.H; Konfirmim i datës 24.10.2022; Vendim për kryerjen e punëve të përkohshme shtesë në Komunën e Obiliqit në Shërbimin Civil me numër të protokollit Nr.II-1466 i datës 24.10.2022; Vendim me numër Nr.222 i datës 14.03.2023; Kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore me numër të protokollit Nr.II-1725 i datës 09.12.2022; Përgjigje me numër Nr.II-1601 e datës 17.11.2022; Raport i ekspertit shqyrtues i datës 11.11.2022; Vendim me numër XII-09 i datës



10.01.2023; Vendim i datës me numër Nr.XII-64 i datës 20.04.2023; E-mail i datës 31.05.2023; E-mail i datës 05.06.2023.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankueses të *kthehet në rivlerësim, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesja në ankesën me numër të protokollit 3615/2023 të datës 14.04.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka theksuar që *"Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022"* për periudhën nëntë (9) mujore, konkretisht nga data 22.04.2022 deri më 20.10.2022 e ka pranuar më datë 16.03.2023 fizikisht për nënshkrim, ndërsa më datë 17.03.2023 përmes e-mailit zyrtar ankuesja ka informuar Departamentin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit që nuk e pranon vlerësimin dhe nuk e nënshkruar pasi që nuk pajtohet me këtë vlerësim sepse *"Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022"* sipas pretendimeve ankimore të ankueses është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik përkatësisht me nenin 43 si dhe me nenin 7 dhe 8 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publik.

Kolegji i Këshillit, pasi ka analizuar dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit dhe ankuesja ka konstatuar se, ankuesja në vendin e punës *"Zyrtare e Lartë e Prokurimit"* sipas Autorizimit me numër të protokollit Nr.II-85 të datës 09.02.2022 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit është caktuar si zëvendësuese e përkohëshme e *"Udhëheqësit të Prokurimit"* Sh.H nga data 09.02.2022 deri sa *"Udhëheqësi i Prokurimit"* Sh.H të kthehet nga pushimi, ndërsa e njëjta sipas Autorizimit me numër të protokollit Nr.II/381 të datës 21.04.2022 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit autorizohet që ti kryej të gjitha detyrat si *"Menaxhere e Prokurimit"* nga data 21.04.2022 deri në zgjedhjen e *"Menaxherit të Prokurimit"*. Tutje bazuar në shkresat e lëndës Kolegji i Këshillit ka konstatuar se më datë 18.10.2022 ankuesja ka parashtruar kërkesën me numër të protokollit Nr. XIII/362 drejtuar Kryetarit të Komunës së Obiliqit për heqjen e Autorizimit për pozitën *"Menaxhere e Prokurimit"*, ndërsa më datë 21.10.2022 Kryetari i Komunës së Obiliqit ka nxjerrë Vendim me numër të protokollit Nr.II-1464 me të cilin e ka **shfuqizuar** Autorizimin me numër Nr.II të datës 21.04.2022 ku ankuesja ka kryer detyrat si *"Menaxhere e Prokurimit"* dhe për të njëjtën ka vendosur se që nga data 21.10.2022 ankuesja ti kryej detyrat e punës në bazë të Akt Emërimit me numër Nr.II/13 të datës 01.06.2015 si *"Zyrtare e Lartë e Prokurimit"*. Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesja gjatë vitit 2022 ka pasur më shumë se dy (2) Mbikëqyrës të drejtpërdrejtë, konkretisht nga data 1 Janar 2022 deri më datën 21 Prill 2022, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i saj ka qenë Sh.H, Menaxher i Prokurimit në Komunën e Obiliqit, ndërsa nga data 21 Prill.2022 deri më 21 Tetor 2022 Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i saj ka qenë Kryetari i Komunës së Obiliqit, ndërsa nga data 21 Tetor 2022 deri më datën 31 Dhjetor 2022, Mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë ka qenë B.H, Menaxhere e Prokurimit.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje juridike-administrative, i`u referua Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht nenit 43 paragrafit 1 , 2 dhe 5 i cili përcakton se: *"1.Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në*



përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit ndërsa paragrafi 5 i këtij neni përcakton se : „5. Nëpunësi civil vlerësohet nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse” dhe i njëjti ka vlerësuar se çështja e ndërrimit të mbikëqyrësit është e rregulluar edhe me Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, përkatësisht nenin 5 paragrafin 2 ku përcaktohet se: “2.Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimit vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues”, rrjedhimisht Kolegji referuar dispozitave të cekura si më lartë, konstaton se nëpunësve civil duhet t’u bëhet vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën prej një (1) viti pa marrë parasysh ndërrimin e mbikëqyrësve si në rastin konkret të ankueses. Kolegji në bazë të dëshmive të ofruara ka konstatuar se të njëjtës i mungon “Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022” për periudhën 01 janar 2022 deri më datë 21 prill 2022, dhe periudha nga data 21 Tetor 2022 deri me 31 dhjetor 2022 pra nuk është përfshirë vlerësimi për këtë periudhë konkretisht periudha ku ankuesja ka punuar në vendin e punës si “Zyrtare e Lartë e Prokurimit”, ku mbikëqyrës te drejtpërdrejtë e ka pasur Udhëheqësin e Prokurimit, andaj Kolegji konstaton se ky i fundit është i obliguar që ankueses ti beje vlerësimin e rezultateve të punës dhe të përfshijë në vlerësimin përfundimtar edhe për këto dy periudha.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses është i bazuar pasi që vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022 nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë Kryetari i Komunës, për ankuesen është bërë në kundërshtim me nenin 8 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se:“4.Formulari i vlerësimit siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni i dërgohet nëpunësit, i cili diskutohet në një takim me mbikëqyrësin dhe në afat prej 5 dite kalendarike nëpunësi duhet të shprehet (pajtohet ose nuk pajtohet) me vlerësimin e mbikëqyrësit.”. Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 nga ana e Mbikëqyrësit të saj të drejtpërdrejtë nuk ka pasur asnjë takim paraprak, dhe pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesës është i qëndrueshëm sepse nuk ka asnjë dëshmi që Kryetari i Komunës së Obiliqit në cilësinë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë në fund të periudhës së vlerësimit e ka ftuar ankuesen për të diskutuar për realizimin e objektiveve dhe rezultateve të arritura, ashtu siç parashihet me nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë, i cili përcakton se: “Vlerësimi përfundimtar i realizimit të objektiveve dhe i aftësive profesionale të nëpunësit bëhet në fund të periudhës vlerësuese në bazë të një procesi, që përfshin: takimi për diskutimin e realizimit të objektiveve dhe rezultateve të arritura; vlerësimin (notimi) e objektiveve”.

Po ashtu ankuesja ka kontestuar të gjithë kapitujt e vlerësimit nga I-III, sepse vlerësimi i rezultateve të punës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk është real, është tendencioz dhe i pabazuar në prova dhe fakte, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave lidhur me vlerësimin e ankuesit për vitin 2022, ka konstatuar se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit konkretisht Kryetari i Komunës së Obiliqit, ankuesen e ka vlerësuar me notën e përgjithshme 2.1 mirëpo tek pjesa e komenteve për asnjë nga objektivat apo aftësitë nuk ka shprehur mendimin se





pse është vlerësuar ankuesi me këtë notë, gjegjësisht nuk ka shpjeguar as edhe një koment të vetëm dhe ta jap mendimin lidhur me përmbushjen apo jo të njëjës prej objektivave dhe detyrave të punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në prova dhe fakte të ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses ka vërtetuar se të njëjtat janë pjesërisht të bazuara, andaj Kryetari i Komunës së Obiliqit në cilësinë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë është i obliguar të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesen për periudhën kur ky ka qenë mbikëqyrës i saj nga data 21 Prill.2022 deri më 21 Tetor 2022, respektivisht të behet vlerësimi nga Udhëheqësi i Prokurimit si mbikëqyrës i saj i drejtpërdrejtë edhe për periudhën nga data 1 janar 2022 deri me date 21.04.2022 dhe nga data 21.10.2022 deri me datë 31.12.2022, në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, dhe nenin 4 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 pika 1.2.1 deri në 1.2.6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave obligon Kryetarin e Komunës së Obiliqit, si Udhëheqësin më të lartë administrativ që të ndër marrë të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me të gjeturat e këtij vendimi të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2022 për ankuesen si dhe të gjitha procedurat dhe afatet që kanë të bëjnë me procedurën e vlerësimit të rezultateve të punës t'i zhvillojnë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e Kryetares së Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se Vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë Konflikt Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i Konfliktit Administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.642/2023.**

Kaltrina Avdullahj Prenaj

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsorë Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK.